



BULETIN



PËRGJEGJSHMËRIA E DEPUTETËVE DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin informativ / Nr.32

TETOR 2006

Projekt i QSP-së për Monitorimin e Veprimtarisë së Parlamentit me Mbështetjen e Fondacionit "Shoqëria e Hapur" SOROS

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE 4-22 shtator 2006

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

1. Gjatë periudhës 4-22 shtator 2006 Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Më datë 13 shtator mbledhja e parashikuar në kalendar u anulua. Në 6 mbledhje janë zhvilluar gjithsej 240 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 40 minuta për mbledhje. Në një rast mbledhja e datës 12.09.06 ka zgjatur vetëm 3 minuta, ndërkohë që ka filluar 37 minuta me vonesë. Në këtë mbledhje njëri nga deputetët e opozitës bëri vërejtje për vonesat e deputetëve në mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbledhjet e projektligjeve përkatëse.

Në mbledhjen e datës 19 shtator ka qenë i pranishëm edhe Zëvendëskryeministri z.Ilir Rusmaili. Ka patur debate dhe dis-

(Vijon në faqen 2)

RASTE VËZHGIMI Procesi i shqyrtimit të projektligjeve të veçanta

Projektligji "Për Librin në Republikën e Shqipërisë"

Projektligji "Për Librin në Republikën e Shqipërisë" është depozituar në Kuvend më datë 21.07.2006 dhe është përfshirë në programin e punimeve të Kuvendit më datë 7.09.2006. Është parashikuar që të shqyrtohet në kalendarin 3-javor të periudhës 4-22 shtator 2006. Sipas këtij kalendar është parashikuar që të kalojë në Komision më datë 22.09.06 dhe më datë 25.09.06 në seancë plenare. Ky projektligj është paraqitur nga Qeveria (Me propozim të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve).

Komisioni përgjegjës për shqyrtimin e këtij projektligji është Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Për këtë projektligj nuk kanë dhënë mendim komisione të tjera parlamentare.

Projektligji ka kaluar në 2 mbledhje komisioni. Mbledhja e parë është zhvilluar në punimet e sesionit të kaluar. Në këtë mbledhje është zhvilluar një seancë dëgjimore ku kanë qenë të pran-

(Vijon në faqen 3)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Monitorimi i Veprimtarisë së Komisioneve Parlamentare për periudhën 4-22 shtator 2006

faqe 1-2

2. Raste vëzhgimi: Procesi i shqyrtimit të projektligjeve të veçanta

faqe 1,3

3. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave për muajin shtator 2006

faqe 4

4. Projektligje në proces Projektligji "Për Akademikët e Shkencave në Republikën e Shqipërisë"

faqe 5-7

5. Kalendarit 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë 25 shtator - 16 tetor 2006

faqe 1, 8-10

KALENDAR I

3 Javor (25 shtator-16 tetor 2006) i Punimeve të Kuvendit Sesioni i III-të Legjislatura e XVII-të

E Hënë, datë 25.9.2006, ora 17.⁰⁰

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, datë 21.09.2006.
3. Miratimi i kalendarit 3 javor të punimeve të Kuvendit.
4. Interpelancë me Ministren e Integritimit kërkuar nga deputeti Taulant Balla.

(Vijon në faqen 8)

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

4-22 shtator 2006

(Vijon nga faqja 1)

kutime nga deputetët vetëm për disa projektligje. Deputetët duken të informuar për projektligjet në të cilat zhvillojnë debate dhe diskutime, por në projektligjet me objekt ratifikim të konventave ose marrëveshjeve të ndryshme deputetët, në përgjithësi, nuk rezultojnë të jenë të informuar paraprakisht duke i kaluar ato pa debate e diskutime.

3. Gjatë monitorimit është konstatuar se vetëm një pjesë e deputetëve marrin pjesë në diskutime dhe debate. Ka dhe deputetë që nuk kanë bërë asnjë diskutim në 6 mbledhjet e zhvilluara. Në 6 mbledhje të realizuara numërohen rreth 21 diskutime nga deputetët. Gjithashtu janë propozuar 4 amendamente më shumë të karakterit teknik.

4. Mungesa e deputetëve në mbledhje është një problem tjetër i konstatuar gjatë monitorimit. Mesatarisht mungojnë 6 deputetë për mbledhje, por ka raste kur numri i mungesave është më i madh. Gjatë monitorimit janë konstatuar vonesa të shumta të deputetëve të cilat në disa raste kanë bërë që mbledhja të fillojë me vonesë (në një rast 1 orë me vonesë). Ka patur edhe raste kur deputetët vetëm sa kanë firmosur prezencën dhe janë larguar përsëri ndërkohë që mbledhja ka vazhduar normalisht.

5. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore si dhe nuk janë zhvilluar veprimtari të tjera kontrolluese. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim ose ndonjë raport kontrolli.

6. Gjatë monitorimit në mbledhjen e datës 19 shtator 06 kur ishte i pranishëm edhe Zëvendëskryeministri z. Ilir Rismaili mbledhja është zhvilluar me dyer të mbyllura. Një fakt i tillë nuk është pasqyruar në procesverbalin e mbledhjes. Në rastet e tjera mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media.

Disa vlerësime: Siç rezultojnë nga monitorimi, nuk ka një pjesëmarrje të rregullt të deputetëve në mbledhjet e komisionit. Ndodh jo rallë që deputetët të vijnë me vonesë dhe të largohen përpara mbylljes së mbledhjes. Gjithashtu, nga verifikimi i procesverbalit dhe informacionit të marrë gjatë monitorimit rezultojnë se disa deputetë kanë firmosur list prezencën pa qenë të pranishëm në mbledhje. Nuk rezultojnë një pjesëmarrje aktive e deputetëve në çështjet që diskutohen në komision. Ka dhe deputetë që nuk kanë marrë pjesë në asnjë diskutim në 6 mbledhjet e zhvilluara. Mbështetja e Komisionit, gjatë shqyrtimit të çështjeve, vetëm në burimin e informacionit të qeverisë pengon komisionin për të bërë një vlerësim me të gjerë të çështjeve nga shumë këndvështrime dhe duke konsultuar burime të ndryshme.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

1. Gjatë periudhës 4 – 22 shtator 2006 Komisioni i Ekonomisë dhe Financave ka zhvilluar gjithsej 8 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Kohëzgjatja e mbledhjeve varion nga 5 deri në 75 minuta. Gjatë 8 mbledhjeve janë zhvilluar gjithsej 270 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 35 minuta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse. Nuk është shfrytëzuar ndonjë ekspertizë apo burim tjetër. Në përgjithësi një projektligj kalon në një mbledhje të komisionit me përjashtim të ndonjë projektligji të rëndësishëm i cili ka kaluar në 2 ose 3 mbledhje të komisionit. Debate dhe diskutime janë zhvilluar vetëm për projektligjet e rëndësishme ndërsa për marrëveshjet e ndryshme ose projektligjet për ndryshime ligjore kanë kaluar pa debate.

3. Jo të gjithë deputetët kanë marrë pjesë aktive në diskutimet që zhvillohen në mbledhje. Përgjithësisht kanë qenë të njëjtët deputetë aktivë në komision dhe numri i tyre nuk është më shumë se 6 ose 35% e deputetëve. Në 8 mbledhje të realizuara numërohen rreth 32 diskutime nga deputetët. Gjithashtu është propozuar vetëm një amendament me karakter thelbësor, i cili është miratuar dhe dy amendamente

të tjera me karakter teknik të cilat nuk janë miratuar. Nga monitorimi rezultojnë se vetëm një pjesë e vogël e tyre janë të informuar paraprakisht, bazuar në vëzhgimin e pjesëmarrjes së tyre në mbledhje.

4. Përsa i përket pjesëmarrjes së deputetëve në mbledhje në asnjë rast nuk kanë qenë të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit. Mungesat variojnë nga 4 deri në 7, mesatarisht mungojnë 5 deputetë për mbledhje. Gjatë monitorimit janë konstatuar vonesa të shumta të deputetëve të cilat në disa raste kanë bërë që mbledhja të fillojë me vonesë (në një rast 1 orë me vonesë). Ka patur edhe raste kur deputetët vetëm sa kanë firmosur prezencën dhe janë larguar përsëri ndërkohë që mbledhja ka vazhduar normalisht.

5. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore si dhe nuk janë zhvilluar veprimtari të tjera kontrolluese. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim ose ndonjë raport kontrolli.

Disa vlerësime: Gjatë monitorimit janë konstatuar 3 raste (në datat 12;13 dhe 18) kur komisioni pasi ka mbyllur diskutimet dhe votimin për projektligje të rendit të ditës ka vazhduar mbledhjen me dyer të mbyllura. Një fakt i tillë nuk është pasqyruar në procesverbalet e mbledhjeve. Gjithashtu nga informacioni i marrë rezultojnë se nuk është marrë asnjë vendim për të zhvilluar mbledhje me dyer të mbyllura. Në rastet e tjera mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media. Një problem tjetër i konstatuar gjatë monitorimit ishte largimi i deputetëve nga mbledhja para përfundimit të saj. Nuk rezultojnë një pjesëmarrje aktive e deputetëve në çështjet që diskutohen në komision. Siç u përmend dhe më sipër, edhe në këtë Komision konstatohet mbështetja vetëm në burimin e informacionit të qeverisë. Ky fakt pengon komisionin për të bërë një vlerësim me të gjerë të çështjeve nga shumë këndvështrime dhe duke konsultuar burime të ndryshme.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

1. Gjatë periudhës 4 – 22 shtator 2006 Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar gjithsej 3 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar por jo në datë dhe orë të caktuar. Njëra nga mbledhjet është zhvilluar me dyer të mbyllura. Ky fakt nuk është pasqyruar në procesverbal. Më datë 22 shtator kohëzgjatja e mbledhjes ka qenë 1 orë e 50 minuta ndërsa në dy mbledhjet e tjera nga 30 minuta gjithsej 170 minuta punë efektive në komision.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse. Nuk është shfrytëzuar ndonjë ekspertizë apo burim tjetër.

3. Gjatë monitorimit është konstatuar se vetëm një pjesë e deputetëve marrin pjesë në diskutime dhe debate. Ka nga ata deputetë që nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në diskutime. Në 3 mbledhje të realizuara numërohen rreth 13 diskutime nga deputetët. Gjithashtu janë propozuar 3 amendamente gjatë shqyrtimit të projektligjit "Për librin" kryesisht të karakterit teknik.

4. Në 3 mbledhje të zhvilluara kanë munguar gjithsej 10 deputetë ose mesatarisht 3 deputetë për mbledhje, por ka raste kur numri i mungesave është më i madh.

5. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore si dhe nuk janë zhvilluar veprimtari të tjera kontrolluese. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim apo ndonjë raport kontrolli.

Disa vlerësime: Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar por jo në datë dhe orë të caktuar. Ky fakt krijon vështirësi për zhvillimin e tyre, por edhe për të interesuarit (media, grupe interesi, vizitorë etj). Njëra nga mbledhjet është zhvilluar me dyer të mbyllura. Ky fakt nuk është pasqyruar në procesverbal.

RASTE VËZHIMI: PROCESI I SHQYRTIMIT TË PROJEKTLIGJEVE TË VEÇANTA

(Vijon nga faqja 1)

ishëm edhe përfaqësues të Shoqatës së Botuesve të Shqipërisë. Mbledhja e dytë është zhvilluar më datë 22 shtator 2006 dhe ka zgjatur 1 orë e 50 minuta. Në këtë mbledhje Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik diskutoi nen për nen projektligjin: “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, paraqitur nga Qeveria. Në mbledhje ishin të pranishëm Zëvendësministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, z. Neritan Alibali, dhe specialistë – juristë të kësaj Ministrie. Për hartimin e këtij projektligji, sipas sqarimeve të z. Alibali, ka punuar një grup pune pranë Ministrisë, i përbërë nga personalitete të shquara të fushës së kulturës dhe botimeve. Po kështu janë marrë në konsideratë, në mënyrë selektive, edhe mendime dhe sugjerime të grupeve të interesit, të përfaqësuar kryesisht nga Shoqata e Botuesve të Shqipërisë.

Projektligji fokusohet kryesisht në vendosjet e një ekuilibri sa më të plotë, në mes të librit si produkt i mirëfilltë kulturor dhe si mall, produkt industrial, objekt i një biznesi privat. Njëkohësisht ky projektligj synon në përafrimin me legjislacionet europiane për librin; mbrojtjen e së drejtës së qytetarit për informim dhe formim nëpërmjet librit dhe kulturës tjetër të shkruar; ndërtimin e një politike efikase në fushën e botimeve, prodhimeve e shpërndarjes së librit; krijimin e një klime të përshtatshme për nismat private në këtë fushë; duke mundësuar një zhvillim sa më harmonik të iniciativave private e lejuar një konkurrencë sa më të ndershme në këtë drejtim. Disa nga pikat e rëndësishme të projektligjit, ndërmjet të tjerave, janë: Krijimi i Këshillit Kombëtar të Librit dhe Nxitjes së Leximit si një organ këshillimor i Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; krijimi i një fondi për librin në buxhetin vjetor të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për botimin e veprave me rëndësi kombëtare, historike, kulturore e shkencore. Komisioni u shpreh parimisht dakord duke pranuar edhe propozimet e bëra për nene të veçanta. Pas diskutimit nen për nen dhe vërejtjeve konkrete për nene të veçanta, të cilat u pasqyruan në raport, Komisioni u shpreh pro kalimit të projektligjit për miratim në seancë plenare.

Si burim informacioni kanë shërbyer ekspertiza e përfaqësuesve të qeverisë e cila, sipas tyre, është mbështetur edhe në mendimet dhe sugjerimet e bëra nga grupet e interesit sidomos nga “Shoqata e Botuesve të Shqipërisë”. Një burim tjetër i rëndësishëm ka qenë edhe seanca dëgjimore e zhvilluar nga Komisioni në punimet e sesionit të kaluar. Nuk ka informacion lidhur me përgjigjet që i janë dhënë pretendimeve të ngritura nga grupet e interesit dhe argumentet e përdorura.

Projektligji u miratua në seancën plenare të datës 27.09.06 megjithëse ishte parashikuar në rendin e ditës të datës 25.09.06.

Projektligji “Për Këshillin Konsultativ të Biznesit”
Projektligji “Për Këshillin Konsultativ të Biznesit” është depozituar në Kuvend më datë 7.07.2006 dhe është përfshirë në programin e punimeve të Kuvendit më datë 7.09.2006. Është parashikuar që të shqyrtohet në kalendarin 3-javor të periudhës 4-22 shtator 2006. Sipas këtij kalendarit është parashikuar që të kalojë në Komision më datë 7.09.06 dhe më datë 11.09.06 në seancë plenare. Ky projektligj është paraqitur nga Qeveria (Me propozim të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës).

Komisioni përgjegjës për shqyrtimin e këtij projektligji është Komisioni për Ekonominë dhe Financat. Është parashikuar që të japë mendim edhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Projektligji ka kaluar në 1 mbledhje të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të zhvilluar më datë 7.09.06 e cila ka zgjatur 1 orë e 48 minuta. Gjithashtu për këtë projektligj ka dhënë mendim edhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Ad-

ministratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në dy mbledhje të zhvilluara më datë 7 dhe 11 shtator 2006.

Në mbledhjen e datës 7 shtator 2006 Komisioni për Ekonominë dhe Financat shqyrtoi projektligjin “Për Këshillin Konsultativ të Biznesit”. Të pranishëm në mbledhje ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

Në këtë projektligj propozohet krijimi i Këshillit Konsultativ të Biznesit si një strukturë institucionale buxhetore, e cila do të shërbejë për përgatitjen e rekomandimeve për Këshillin e Ministrave dhe për Kuvendin në procesin e hartimit të politikave shtetërore ekonomike afatgjata dhe të projektligjeve për buxhetin e shtetit, paketat fiskale, privatizimet, prokurimin publik, Investimet, zhvillimin e tregtisë dhe biznesit, konkurrencën dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Ky Këshill do të ketë në përbërje përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, shoqatave të biznesit, shoqërisë civile, institucioneve shtetërore dhe pushtetit vendor dhe do të drejtohet nga ministri përgjegjës për ekonominë. Ai do të mbështetet nga një sekretariat teknik, i cili do të kryejë veprimtarinë administrative. Kryetari i Këshillit të Biznesit emëron anëtarët e Këshillit Konsultativ të Biznesit dhe sekretariatit teknik.

Shumica e anëtarëve të Komisionit u shprehën dakord me projektligjin, me argumentin që institucioni që propozohet të krijohet me këtë projektligj do t'i përfaqësojë më mirë interesat e biznesit pranë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit në procesin e hartimit të strategjive dhe të projektligjeve ekonomike dhe financiare.

Dy prej anëtarëve të Komisionit u shprehën se interesat e biznesit nuk mund të përfaqësohen dhe mbrohen nga një strukturë e përbashkët këshillimore, me përfaqësues nga biznesi dhe Qeveria dhe se ngritja e kësaj struktura lë shteg për abuzime ndaj biznesit.

Pas përfundimit të diskutimit, Komisioni e miratoi projektligjin me 8 vota pro dhe 2 kundër.

Për këtë projektligj në dy mbledhje të zhvilluara përkatësisht më datë 7 dhe 11 shtator 2006 ka dhënë mendim edhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Gjatë shqyrtimit të projektligjit ishte i pranishëm edhe Zëvendësministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës si dhe Drejtori Juridik i kësaj Ministrie të cilët mbrojtën projektligjin. Komisioni e vlerësoi projektligjin duke konstatuar se hartimi i këtij projektligji i shërben krijimit të një baze ligjore për përmirësimin e mekanizmave të bashkëpunimit publik-privat. Komisioni i ligjeve me shumicë e miratoi projektligjin në parim, duke u shprehur se ky projektligj është akti i duhur normativ që përmbush kërkesat për krijimin e bazës ligjore në këtë fushë. Komisioni e miratoi projektligjin nen për nen duke bërë vetëm disa ndryshime dhe saktësime të karakterit teknik. Projektligji u miratua në seancë plenare më datë 11.09.06. Kohëzgjatja e shqyrtimit të projektligjit në seancë ishte 25 minuta. Gjatë shqyrtimit të projektligjit në seance deputetët nuk shfaqën shumë interes duke mos zhvilluar debate. Edhe diskutimet e deputetëve ishin të shkurtra dhe të përmbledhura. Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen u bënë disa ndryshime më shumë të karakterit teknik. Projektligji u miratua në seancë me 68 vota pro, 4 kundër dhe 5 abstenime.

Në shqyrtimin e këtij projektligji, në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm, evidentojmë dy probleme: Së pari, koha dhe debati i kushtuar nga komisionet për shqyrtimin e këtij projektligji nuk tregojnë se projekti është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe në thellësinë e duhur; Së dyti, komisionet, do të bënin një vlerësim më të drejtë nëse do të kishin zhvilluar seancë dëgjimore me grupet e interesit.

NGA MBLEDHJET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MUAJIN SHTATOR 2006

I. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

datë 07.09.2006

VENDIME për propozime projektligjesh

1. Propozim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidatëve për anëtarë të bordit të autoritetit të mbikqyrjes financiare.

2. Propozimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9323, datë 25.11.2004, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar".

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 07.09.2006

1. Miratimin e ndryshimeve në marrëveshjen e grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD), për programin për lehtësimin dhe futjen e fermerëve në tregjet e zonës Ballkanike.

2. Për disa ndryshime në vendimin nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar.

3. Përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore.

4. Përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar.

5. Disa ndryshime në vendimin nr.561, datë 16.8.2006, "Për pagat sipas gradave për punonjësit, oficerë e nënofficerë, të gardës së Republikës së Shqipërisë".

6. Kalimin e disa mjediseve në përgjegjësi administrimi të grupit mbikqyrës, për ushtrimin e veprimtarisë së këtij institucioni.

7. Disa ndryshime në vendimin nr.405, datë 27.7.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kushtet e nxjerrjes së pullës postare shqiptare".

8. Miratimin e dokumentit "Strategjia kombëtare për transfuzion gjaku të sigurtë"

9. Miratimin, në parim, të marrëveshjes "Menaxhimi i integruar i ekosistemit të Liqenit të Prespës në Shqipëri, Maqedoni dhe Greqi", që do të zbatohet në bashkëpunim me programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

10. Një shtesë në vendimin nr.55, datë 28.1.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të repartit infektiv të spitalit të Elbasanit, nga Ministria e Shëndetësisë të Ministria e Arsimit dhe Shkencës".

11. Miratimin, në parim, të protokollit dypalësh, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë, për përcaktimin e pikave të hyrje-daljeve të nftësjellësit transballkanik AMBO, në kufirin ndërmjet teritorreve të të dyja vendeve.

12. Përdorimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të identitetit të shtetasve nga organet e administratës publike.

II. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

datë 15.09.2006

VENDIME për propozime projektligjesh

1. Për propozimin e projektligjit "Për dhomat e tregtisë dhe industrisë".

2. Për propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës

së Shqipërisë, përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar i Bisedimit të Borxhit të Jashtëm, dhe shoqërisë "MALI", Gjakovë, për riskedulimin e borxhit të prapambetur".

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 15.09.2006

1. Për miratimin në parim, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin "Reforma për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe fuqizimin institucional".

2. Për miratimin e e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.840, datë 17.12.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të trupit Diplomatik".

4. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave.

III. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

datë 20.09.2006

VENDIME për propozime projektligjesh

1. Propozimin e projektligjit "Për një shtesë në ligjin nr. 9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake".

2. Propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant' Egidio-s, për selinë dhe veprimtarinë e këtij komuniteti në Shqipëri".

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 20.09.2006

1. Një shtesë në ligjin nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake".

2. Ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant' Egidio-s, për selinë dhe veprimtarinë e këtij komuniteti në Shqipëri".

3. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë Universitare, jopublike, "Universiteti European i Tiranës"

4. Disa ndryshime në vendimin nr.198, datë 05.04.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për pranimet në Universitetet dhe shkollat e larta, për vitin akademik 2006 – 2007, në sistemin me kohë të plotë, si dhe për përcaktimin e tarifës së shkollimit", të ndryshuar.

5. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrjetit të ri të Ujësjellës –Kanalizimeve, në Fushë-Krujë.

6. Disa ndryshime në vendimin nr.445, datë 26.6.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për inspektimin e punës së detarëve"

7. Miratimin, në parim, të marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin vjetor të veprimit CARDS 2006 për Shqipërinë"

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë"

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN "PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Qëllimi i këtij projektligji është të përgatisë bazën ligjore për reformimin e institucionit të Akademisë së Shkencave (ASH), në përputhje me rekomandimet e studimit të grupit të ekspertëve dhe me përfundimet e nxjerra nga diskutimet publike të zhvilluara. Ligji në fjalë do të shërbejë si bazë për hartimin e statutit të ri, i cili rregullon veprimtarinë e kësaj akademie, të reformuar.

Vlerësimi politik i projektaktit

Gjatë periudhës së tranzicionit, rrjeti i kërkimit shkencor në vendin tonë ka pësuar pak ndryshime në këndvështrimin institucional dhe, për rrjedhojë, nuk ka arritur të pasqyrojë ndryshimet, që kanë ndodhur në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare, veçanërisht për sa i takon lidhjes ndërmjet arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Qeveria e re, e dalë nga zgjedhjet e 3 korrikut 2005, ka përcaktuar zhvillimin e shpejtë të arsimit dhe shkencës dhe, në këtë kuadër, ndërtimin e një sistemi modern të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, si njëri ndër përparësitë kryesore të programit të vet. Përmes zhvillimit e modernizimit të sistemit të arsimit të lartë dhe shkencës synohet jo vetëm rritja, deri në liberalizim, e pranimit të rinjve në arsimin e lartë, por edhe ngritja e nivelit të arsimit dhe të efektivitetit të kërkimit shkencor, si rrugë kryesore për të rritur mundësitë e brezit të ri shqiptar për edukim, punësim dhe një jetë më të mirë, si edhe për t'i paraprirë integritet në Bashkimin Europian (BE). Arritja e këtij qëllimi madhor e bën të domosdoshme një reformë, të thellë dhe të shpejtë, në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

Përmbajtja e përmbledhur e projekt-aktit

Një grup ekspertësh, prej dhjetë profesorësh, i krijuar me urdhrin nr. 171, datë 2.11.2005, të Kryeministrit, kishte si mision të studionte sistemin e kërkimit shkencor të vendit tonë dhe, mbi këtë bazë, të përpunonte rekomandime për reformimin e tij. Studimi u krye në bazë të një skede, e cila u plotësua nga institutet. Në të jepen të dhëna të hollësishme për burimet njerëzore, kapacitetet për kërkim (hapësira, laboratorë, biblioteka, etj), buxhetin dhe të ardhurat dhe për "produktin" shkencor (projekte, botime, patenta). Grupi i ekspertëve, në fund të janarit të vitit 2006, i dorëzoi Kryeministrit një raport të plotë, i cili iu dërgua edhe Akademisë së Shkencave, si dhe të gjitha ministrive e universiteteve. Ky raport u botua edhe në website të Kryeministrit dhe në internet. Rekomandimet e këtij studimi u diskutuan në një sërë konferencash publike dhe në takime të ngushta, me palët e interesuara. Në bazë të këtyre diskutimeve grupi i ekspertëve aktualizoi raportin e tij dhe rekomandimet për Këshillin e Ministrave.

Përfundimet kryesore të studimit të grupit të ekspertëve janë:

- Sistemi i kërkimit shkencor në Shqipëri përmban burime, njerëzore dhe materiale, të ndjeshme. Megjithatë, forma institucionale e këtij sistemi, ndarja e arsimit të lartë nga kërkimi shkencor, është e vjetëruar dhe ka një efektivitet të ulët në përdorimin e burimeve, njerëzore dhe materiale, për shkak, kryesisht, të kësaj ndarjeje.

- Raporti ndërmjet buxhetit total për institutet jashtëuniversitare dhe atij të përcaktuar për kërkim shkencor është i padrejtë. Buxheti total i instituteve jashtëuniversi-

tare, për vitin e marrë në studim (2004), ishte 1,65 miliardë lekë. Financimi për kërkimin e mirëfilltë shkencor (në formën e programeve kombëtare dhe të projekteve) ishte vetëm 100 milionë lekë, që do të thotë as 10 për qind e të gjithë fondit që jepet për institucionet jashtëuniversitare të kërkimit. Nga ky fond, universitetet kanë marrë vetëm 30 milionë lekë për kërkimin shkencor, fond ky krejtësisht i pamjaftueshëm, dhe ka bërë që universitetet të mos kenë mundësi të zhvillojnë kërkime shkencore, që janë po aq të rëndësishme sa edhe mësimi. Këto të dhëna tregojnë se paratë u përdorën për të financuar një personel të tejfryrë të rrjetit të instituteve, dhe jo kërkimin e mirëfilltë shkencor.

- Niveli i kërkimit shkencor është ende i ulët dhe nuk e justifikon investimin që bëhet, kryesisht, për të paguar personelin, duke qenë kështu faktor për një prapambetje në zhvillimin e mendimit shkencor, në disa fusha të shkencës. Një gjendje e tillë vë në pikëpyetje jetën shkencore të institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në vendin tonë.

- Sistemi nuk ka struktura të qarta institucionale të politikëbërjes, drejtimit, administrimit dhe vlerësimit të kërkimit shkencor dhe zhvillimit.

Në kuadër të sistemit të kërkimit shkencor, Akademia e Shkencave zë një vend të veçantë. Ajo ka në përbërje 14 institute dhe qendra kërkimore shkencore.

Studimi i grupit të ekspertëve ka dhënë këto **rekomandime kryesore** për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave:

1. Integrimi, institucional dhe administrativ, i instituteve kërkimore të Akademisë së Shkencave në sistemin e arsimit të lartë.

Institutet kërkimore duhet të shkëputen prej Akademisë së Shkencave dhe të integrohen në sistemin e riorganizuar të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor. Grupi i ekspertëve propozon krijimin e tri qendrave kërkimore ndërdisiplinore, në bazë të instituteve kërkimore të Akademisë së Shkencave, të ministrive të linjës dhe të disa strukturave ekzistuese të universiteteve të Tiranës, si:

- Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike;
- Qendra Kërkimore Universitare e Ujit, Energjisë dhe Mjedisit, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës;
- Qendra Kërkimore Universitare e Gjeoshkencave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.

Si dhe dy fakulteteve të reja:

- Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit,
- Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit .

Disa institute kërkimore, që nuk përfshihen në qendrat dhe fakultetet e mësipërme dhe që kanë kapacitete të mira për kërkim, bashkohen me departamentet homologe të universiteteve të Tiranës.

2. Akademia e Shkencave mbetet institucion përfaqësues i mendimit shkencor në vendin tonë, por shndërrohet në një akademi, me rol, honorifik dhe këshillues, për shkencën shqiptare.

Pas shkëputjes së instituteve kërkimore, struktura e Akademisë së Shkencave duhet të ndryshojë, për t'iu përshatur rolit honorifik të saj.

Detyrat më të rëndësishme do të jenë:

- Propozimi i fushave të reja, kërkimore e studimore, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit;

(vijon në faqen 6)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë"

(Vijon nga faqja 5)

- Ofrimi institucioneve të larta shtetërore i këshillave dhe ekspertizës së nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për zhvillimin e vendit.

- Vendosja e bashkëpunimit me institucionet mësimore-kërkimore, të artit e të kulturës, brenda dhe jashtë vendit;

- Organizimi i kongreseve dhe i konferencave, në shkallë kombëtare e ndërkombëtare;

- Botimi i organeve periodike dhe i veprave të tjera, me vlerë shkencore;

- Organizimi i konkurseve dhe dhënia e çmimeve shkencore.

Për realizimin e detyrave të mësipërme, Akademia e Shkencave bashkëpunon edhe me strukturat e tjera, këshillimore dhe ekzekutive, të sistemit të arsimit të lartë dhe shkencës, si Këshilli i Arsimit të Lartë e Shkencës dhe Fondacioni i Shkencës (këto dy struktura rekomandohen në studimin e grupit të ekspertëve). Procedurat për ngritjen e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës kanë filluar.

Për realizimin e detyrave, Akademia e Shkencave do të ketë Asambleenë e Akademikëve (si konferenca e përgjithshme e anëtarëve), kryesinë dhe këshillin ekzekutiv.

Rekomandimet e tjera, për reformën në sistemin e kërkimit shkencor, si dhe hollësitë, janë dhënë në raportin e plotë të grupit të ekspertëve, me të cilin janë njohur të gjitha institucionet e sistemit të kërkimit dhe arsimit të lartë, ministritë dhe institucionet e tjera, në varësi të tyre.

Përmbledhje:

Projektligji synon të përcaktojë kuadrin ligjor në bazë të të cilit Akademia e Shkencave do të hartojë statutin e ri në përputhje me rekomandimet e studimit të bërë nga grupi i ekspertëve. Reforma institucionale e sistemit të kërkimit shkencor, dhe, në këtë kuadër, edhe e Akademisë së Shkencave, u përgjigjet tërësisht objektivave të programit të qeverisë.

Riorganizimi institucional i Akademisë së Shkencave parashikon, në thelb, shkëputjen institucionale prej saj të instituteve kërkimore dhe integrimin e tyre në sistemin e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, si dhe shndërrimin e Akademisë në një institucion honorifik, përfaqësues të mendimit shkencor në vendin tonë.

PROJEKTLIGJ

"PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë (në vazhdim Akademia) është institucion shkencor, që vepron nëpërmjet një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh.

Neni 2

1. Akademia është person juridik publik.
2. Akademia e ka selinë në Tiranë dhe ka stemën e vet. Statuti i saj miratohet nga asambleja.

Neni 3

Akademia është institucion autonom, i cili e mbështet veprimtarinë në të vërtetën shkencore dhe në interesat kombëtare. Ajo vepron sipas ligjeve në Republikën e Shqipërisë dhe statutit të saj.

KREU II

FUNKSIONET E AKADEMISË SË SHKENCAVE

Neni 4

Funksionet

Akademia ka këto funksione:

- a) Bashkëpunon me institucione kërkimore dhe mësimore, brenda dhe jashtë vendit, që kanë kapacitetet e nevojshme fizike për kërkim, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës;
- b) Propozon fusha të reja, kërkimore e studimore, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit;
- c) U ofron institucioneve të larta shtetërore këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për zhvillimin e vendit;
- c) Boton organe periodike dhe vepra të tjera me nivel të lartë shkencor;
- d) Organizon kongrese dhe konferenca, shkencore dhe problemore, në shkallë kombëtare e ndërkombëtare;
- dh) Organizon konkurse dhe dhënie çmimesh shkencore.

KREU III

PËRBËRJA E AKADEMISË

Neni 5

Anëtarët e Akademisë

1. Akademia ka në përbërje anëtarë të rregullt, anëtarë të asociuar dhe anëtarë nderi.
2. Anëtarët e rregullt të Akademisë mbajnë titullin "Akademik". Ata janë jo më shumë se 30 veta.
3. Anëtarët e asociuar të Akademisë mbajnë titullin "Akademik i asociuar" dhe të tillë janë 15 veta.
4. Anëtarë nderi të Akademisë janë personalitete të njohura të vendeve të tjera.

Neni 6

Përzgjedhja e anëtarëve

1. Anëtarët e rregullt të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve të shquar, me titull "Profesor", me shtetësi shqiptare, të cilët, nëpërmjet punimeve origjinale, veprave përgjithësuere, me një nivel të lartë shkencor, kanë zgjidhur, teorikisht dhe praktikisht, probleme të një rëndësie të veçantë në fushën e shkencës, të ekonomisë, të artit dhe të kulturës, si dhe kanë dhënë ndihmesë në formimin, universitar e pasuniversitar, të shkencëtarëve të rinj.
2. Në raste të veçanta, anëtarë të rregullt të Akademisë mund të zgjidhen edhe personalitete, që kanë merita të shquara në fusha të ndryshme të krijimtarisë.
3. Anëtarët e asociuar të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve, me titull "Profesor", me shtetësi shqiptare, të cilët, nëpërmjet punimeve dhe veprave shkencore kanë dhënë ndihmesë të rëndësishme në zhvillimin e shkencës dhe formimin, universitar e pasuniversitar, të shkencëtarëve të rinj.
4. Anëtarët e nderit zgjidhen nga radhët e personaliteteve të njohura të vendeve të tjera, të cilët kanë dhënë kontribut të shquar në zhvillimin e vendit tonë.
5. Personat, që kanë funksione të larta, administrative dhe politike, nuk mund të kandidojnë për t'u zgjedhur

(Vijon në faqen 7)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë"

(Vijon nga faqja 6)

anëtarë të rregullt dhe të asociuar të Akademisë gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve.

6. Procedurat për zgjedhjen e anëtarëve përcaktohen në statutin e Akademisë.

Neni 7

Shpërblimi i anëtarëve

Anëtarët e rregullt të Akademisë, me banim të përherëshëm në Republikën e Shqipërisë, që janë në marrëdhënie pune, krahas pagës, sipas vendit të punës, përfitojnë edhe shpërblim mujor për titullin "Akademik" në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ata, krahas pensionit që i takon si profesor, marrin edhe shpërblimin për titullin "Akademik".

Neni 8

E drejta e pensionit

Anëtarët e Akademisë, me kërkesë të tyre mund të shlyjnë moshën e daljes në pension deri në 75 vjeç. Pas kësaj moshe ata nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion drejtues, por mund të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Akademisë, pa të drejtë vote.

KREU IV

ORGANET DREJTUESE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE

Neni 9

Organet drejtuese

Organet drejtuese të Akademisë janë asambleja, këshilli ekzekutiv dhe kryesia.

Përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të këtyre organeve drejtuese përcaktohen në statutin e Akademisë.

Neni 10

Përbërja e organeve drejtuese

1. Asambleja është organi më i lartë drejtues i Akademisë dhe përbëhet nga anëtarët e rregullt dhe anëtarët e asociuar.

2. Këshilli ekzekutiv përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve.

3. Kryesia e Akademisë përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari shkencor.

Neni 11

Mënyra e zgjedhjes

1. Kryetari i Akademisë përzgjidhet drejtpërdrejt, me votim të fshehtë nga asambleja, nga radhët e akademikëve. Kryetari, i zgjedhur nga asambleja, emërohet nga Presidenti i Republikës.

2. Zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve duhet të jenë akademikë dhe përzgjidhen nga asambleja, sipas procedurave të përcaktuara në statutin e Akademisë.

3. Kohëzgjatja e mandatit të kryetarit dhe të zëvendëskryetarit është 4 vjet, ndërsa e sekretarit shkencor dhe e drejtuesve të seksioneve është 5 vjet. Kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve mund të zgjidhen në të njëjtin funksion, për dy mandate, por jo radhazi.

Neni 12

Strukturat mbështetëse

Kryesia e Akademisë në ushtrimin e veprimtarisë mbështetet nga administrata, struktura dhe organika e së cilës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

SEKSIONET E AKADEMISË SË SHKENCAVE

Neni 13

Seksionet dhe përbërja e tyre

1. Veprimtaria e Akademisë zhvillohet në kuadër të seksioneve, të cilat janë bartëse të të drejtave, detyrave dhe përgjegjësisive të Akademisë për fusha të ndryshme të shkencës.

2. Detyrat, përgjegjësitë, përbërja, mënyra e drejtimit dhe e funksionimit të seksioneve përcaktohen në statutin e Akademisë.

KREU VI

Neni 14

Financimi

1. Akademia është një institucion buxhetor dhe të ardhurat i siguron nga:

a) buxheti i shtetit;

b) shërbimet tekniko-shkencore, që kryhen për persona, juridikë e fizikë, jashtë sistemit të saj;

c) aplikimet, projektet, dhuratat, subvencionet e sponsorizimet, të cilat përdoren në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi.

2. Të ardhurat e krijuara sipas shkronjave "b" e "c", të pikës 1, të këtij neni, të përdoren në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 15

Struktura dhe organizimi i Akademisë, si edhe statuti i saj të përshtaten në përputhje me këtë ligj, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Akademia e riorganizuar zhvillon zgjedhjet e organeve drejtuese brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 16

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 e 12, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 17

Shfuqizime

Ligji nr.9182, datë 5.2.2004, "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 1)

5. P/ ligji "Për ratifikimin e Konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Koresë, për shmangien e tatimeve të dyfishtë, për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal".

6. P/ ligji "Për librin në Republikën e Shqipërisë".

7. P/ vendim "Për miratimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare".

8. Shqyrtimi i kërkesës së 35 deputetëve "Për ngritjen e komisionit hetimor për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin, familjarët dhe të afërmit e tij".

Veprimtari në Komisione – nga data 26 shtator – 12 tetor 2006

1. P/ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e Programit "Fuzizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".

·Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut

·Komisioni i Jashtëm

·Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

·Komisioni i Sigurisë Kombëtare

2. P/ ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë "HACI SAKIR SABUN VE GLISERINE FABRIKALARI TURK ANONIM SIRKETI "STAMBOLL, TURQI, për riskedulimin e borxhit".

·Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut

·Komisioni i Jashtëm

·Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

3. P/ ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ushtarake grant, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë".

·Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut

·Komisioni i Jashtëm

·Komisioni i Integritit

·Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

4. P/ ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër dopingut në sport, 2005".

·Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut

·Komisioni i Jashtëm

·Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

5. P/ ligji "Për ratifikimin e Protokollit për pranimin e Komunitetit European në Konventën Ndërkombëtare të Eurokontrollit, për bashkëpunimin për sigurinë e navigimit ajror, të 13 Dhjetorit 1960, të ndryshuar me anë të amendimit dhe të konsoliduar nga Protokollin i 27 Qershorit 1997".

·Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut

·Komisioni i Jashtëm

·Komisioni i Integritit

·Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit

6. P/ ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe "Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të përformacës së lartë, në Europën Lindore".

·Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut

·Komisioni i Jashtëm

·Komisioni i Integritit

·Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit

7. P/ ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shumëpalësh të Konventës "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave (CMR).

·Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut

·Komisioni i Jashtëm

·Komisioni i Integritit

(Vijon në faqen 9)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 8)

·Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit

8. P/ ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për financimin e Programit “Rehabilitimi i rrugës Shkodër – Hani i Hotit”.

·Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut

·Komisioni i Jashtëm

·Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

·Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit

9. P/ ligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

10. P/ ligji “Për sistemin e taksave vendore” (nen për nen).

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat

11. P/ ligji “Për Inspektoriatin e Punës dhe Inspektoriatin Shtetëror të Punës”.

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

12. P/ ligji “Për artin skenik”.

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

13. P/ ligji “Për miratimin e Buxhetit Faktik të shtetit të vitit 2005”.

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat

14. P/ ligji “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

15. P/ ligji “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

16. P/ ligji “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat

17. P / ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8618, datë 14.06.2000 “Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

18. P / ligji “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

19. Shqyrtimi i propozimeve të kandidaturave për anëtar të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes financiare”.

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat

20. P / ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare (nismë e 20 mijë zgjedhësve).

Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

Jep mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

E enjte, datë 28.09.2006, ora 10.⁰⁰

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare, datë 25.09.2006.

3. P/ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e Programit “Fuzizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”.

4. P/ ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “HACI SAKIR SABUN VE GLISERINE FABRIKALARI TURK ANONIM SIRKETI “STAMBOLL, TURQI, për riskedulimin e borxhit”.

5. P/ ligji “Për Factoringun”.

(Vijon në faqen 10)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 9)

6. Raport i Komisionit Hetimor "Për hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për eliminimin e kësaj situate monopol".

E hënë, datë 2.10.2006, ora 17.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, datë 28.0.2006.

3. Mocion për zhvillimin e një debati për çështjet kritike të ngritura gjatë debatit për ratifikimin e MSA-së si dhe në Rezolutën e Parlamentit Europian.

E enjte, datë 5.10.2006, ora 10.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, datë 2.10.2006.

3. P/ ligji "Për ratifikimin e Protokollit për pranimin e Komunitetit Europian në Konventën Ndërkombëtare të Eurokontrollit, për bashkëpunimin për sigurinë e navigimit ajror, të 13 Dhjetorit 1960, të ndryshuar me anë të amendimit dhe të konsoliduar nga Protokollin i 27 Qershorit 1997".

4. P/ ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe "Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të performacës së lartë, në Europën Lindore".

5. Raport i KLSH-së "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2005".

6. P/ ligji "Për miratimin e Buxhetit Faktik të Shtetit të vitit 2005".

E hënë, datë 9.10.2006, ora 17.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, datë 5.10.2006.

3. Pyetje dhe Interpelanca.

4. P/ ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ushtarake grant, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë".

5. P/ ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër dopingut në sport, 2005".

6. P/ ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8618, datë 14.6.2000 "Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë".

7. Debat parlamentar "Për domosdoshmërinë e dënimit të krimeve të komunizmit" (kërkuar nga një grup deputetësh).

E enjte, datë 12.10.2006, ora 10.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare datë 9.10.2006.

3. P/ ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shumëpalësh të Konventës "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave (CMR).

4. P/ ligji "Për disa shtesa në ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

5. P / ligji "Për artin skenik".

E hënë, datë 16.10.2006, ora 17.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, datë 12.10.2006.

3. Miratimi i Kalendarit 3 javor të punimeve të Kuvendit.

4. Pyetje dhe Interpelanca.

5. P/ ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për financimin e Programit "Rehabilitimi i rrugës Shkodër – Hani i Hotit".

6. P/ ligji "Për Inspektoriatin e Punës dhe Inspektoriatin Shtetëror të Punës".

7. P/ ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

8. P/ ligji "Për sistemin e taksave vendore" (nen për nen).

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/
Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org